



Rr. "Komuna e Parisit" Nr. 4  
Po. Box. 7435  
Tiranë, Shqipëri.  
Tel. / fax 00355 / 4/ 321389  
[www.misionishenjteroreleonore.org](http://www.misionishenjteroreleonore.org)  
e-mail: [misionel@yahoo.com](mailto:misionel@yahoo.com)  
Dt. 08/07/2007

Nr. 35 Prot.

## L E T E R,

Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Bamir Topi

Duke ju uruar suksese në detyrën Tuaj të lartë dhe fisnike, në shërbim të kombit shqiptar, na lejoni t'ju shprehim solidaritetin me ndjenjat tona me të sinqerta dhe njëkohësisht t'ju themi se jeni pjesë e lutjeve të komunitetit tonë Misionar për mbarevajtjen e detyrës Suaj në favor të ekuilibrit kombëtar.

I nderuar Shkelqesi,

Duke besuar në angazhimin Tuaj serioz dhe përgjegjshmerinë Tuaj në zgjidhjen e problemeve jetike që po kalon populli ynë shqiptar, na lejoni të terbeqim pak vemendjen Tuaj nga keto anagazhime për të shprehur dy nga ngjarjet më madhore që kanë ndodhur në historinë e Misionit Shenjteror Eleonore, fatkeqësi këto kundër besimit të qindra e mijëra besimtarëve të Misionit tonë dhe drejtuesve të Tij.

Me dt **24.05.2007**, dy persona të paidentifikuar kanë hyrë në dhomën e Zonjes së Shpirtit Eleonore, Drejtueses së Misionit tonë, me maska e doreza dhe e helmuan. Sipas rrefimit të vetë Zonjes, këta dy persona kanë hyrë nga dritarja e dhomës së saj dhe e kanë detyruar të pije një shishe me lëng të bardhë. Gjate kësaj tentative për vrasje, ata i kanë deklaruar Zonjes sone se do ta zhdukim atë, familjen dhe Misionin e saj.

Në lidhje me këtë ngjarje kriminale, janë bërë të gjitha kallezimet përkatëse, por ende nuk kemi një prononcim prej shtetit shqiptar.